

KUD 338.24

NDIKIMI I AUDITIMIT TË JASHTËM NË NGRITJEN E CILËSISË SË RAPORTIMIT FINANCIAR

*MSc. Brikenda Vokshi
kenavokshi@yahoo.com*

Abstrakt

Sa me shumë konkurent të aktivizohen në ekonominë e tregut, aq më të rëndësishme për shfrytëzuesit e pasqyrave financiare bëhen informatat financiare të cilat janë të qëndrueshme, të besueshme dhe kuptimplotë. Qeveria mbështetet në raporetet financiare për t'i mbledhë në mënyrë efikase, të drejtë dhe proporcionale tatimet. Ndërmarrjet mbështeten në raporete financiare për thithjen e investimeve, për blerjen e aksioneve dhe pjesëve të ndërmarrjeve tjera. Investuesit mbështeten në raportet financiare për të rritur kapitalin apo zgjeruar operacionet biznesore. Kjo ndikon në dobi të krijimit të vendeve të reja të punës dhe rritjes ekonomike. Në mënyrë që këto shenime financiare të cilat u shërbejnë shfrytëzuesve të jashtëm të jena sa më bindëse, të qëndrueshme dhe të drejta, ato duhet të vërtetohen. Kjo e paraqet detyrën parësore të funksionit të auditimit, njëkohësisht edhe ngritjen e cilësisë së raportimit financiar.

Fjalët kyçe: Pasqyra financiare, auditim, cilësi, raportim, ngritje.

JEL kualifikimi: M4 , M42

1. Hyrje

Auditimi është procesi sistematik i përfitimit dhe vlerësimit objektiv i evidencave të auditimit mbi të cilat mbështeten pohimet e menaxhmentit për veprimet dhe ngjarjet ekonomike të entiteteve të ndryshme në mënyrë që të përfitohet një siguri e arsyeshme mbi shkallën e përputhjes së këtyre pohimeve, kriterëve të vendosura për pregaditjen e tyre si dhe komunikimit të rezultateve përmes pasqyrave të raportuara ndaj palëve të interesuara për to.

Me qëllim që një proces i auditimit të ketë një efekt sa më të madh, auditimi duhet të bazohet në një kornizë konceptuale të shëndoshë dhe më

shumë logjike. Këtë e mundësojnë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA –të) të cilat kanë ndikim global në procesin e auditimit.

Auditimi i jashtëm nuk është pjesë e brendshme e organizatës, është i pavarur nga entiteti të cilin e auditon. Pra, është i pavarur dhe për punën që e bënë kuptohet kompenzohet nga organizata që i ka angazhuar. Zakonisht auditorët e jashtëm bëjnë auditimin e pasqyrave financiare me qëllim që të krijohet një opinion i saktë mbi korrektësinë e veprimeve afariste të organizatës, duke konstatuar a janë përpiluar pasqyrat financiare në pajtim me parimet e përgjithshme për pregaditjen dhe raportimin e tyre.

Auditimi nuk është qëllim në vete por një pjesë e pazëvendësueshme e sistemit rregullator, qëllim i të cilit është zbulimi i devijimeve nga standardet e pranura dhe shkeljet e parimeve të ligjshmërisë efikasitetit, efektshmërisë dhe ekonomisë së menaxhimit financiar; aq herët sa për ta bërë të mundur ndërmarrjen e masave korrektuese në rastet individuale, për të bërë që personat përgjegjës të marrin përgjegjësinë, për të siguruar kompenzimin apo për të ndërmarrë hapa për parandalimin apo të paktën për t'i bërë më të vështira shkeljet e tilla.

2. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare

Qëllimi i matjes dhe i regjistrimit të aktiviteteve të biznesit është që të ofrojë informacione të dobishme për ata të cilët kanë nevojë të marrin vendime. Kontabiliteti raporton informacione për vendimmarrësit në formën e raporteve financiare.

Raportet financiare janë raporte që përmbledhin rezultatet e veprimeve kontabël të një organizate për një periudhë fiskale. Zakonisht, pasqyrat financiare përpilohen dhe prezantohen në bazë të kohës njëvjeqare për një gamë të gjërë të shfrytëzuesve të rëndomtë. Shumë nga këta shfrytëzues mbështeten në këto pasqyra financiare si burim kryesor të informative për arsye se nuk kanë qasje tjetër në informata më të hollësishme për nevojat e tyre të veqanta.

Objektivi i pasqyrave financiare është të japë një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë ekonomike raportuese.

Pasqyrat financiare përdoren nga shfrytëzues të brendshëm dhe të jashtëm.

Pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë së njësisë ekonomike raportuese, sipas Standardit nr.1 të Kontabilitetit vetëm dhe vetëm nëse:⁶⁹

⁶⁹ Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar SNRF, IASCF, 2007, faqe 75

(a) ato janë të sakta e të plota në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

(b) përgatitja e tyre bazohet në vlerësime të arsyeshme e të bazuara (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme);

(c) shënimet në pasqyrat financiare janë përgatitur me detaje të mjaftueshme për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të një njësie ekonomike raportuese, në mënyrë të tillë që lexuesit kompetentë të mund të nxjerrin konkluzione të arsyeshme.

Informacioni kontabël i raportuar nga organizatat duhet të auditohet. Auditimi është ekzaminim i hollësishëm i raporteve financiare të një organizate. Ai përfshin ekzaminimin e sistemit të informimit të përdorur për të pregaditur raportet financiare dhe përfshin ekzaminimin e procedurave të kontrollit që përdorin organizatat për të siguruar saktësinë e informacionit kontabël. Qëllimi i një auditimi është të vlerësojë se kur një informacion që i raportohet marrësve të jashtëm të vendimeve është një paraqitje e drejtë e aktiviteteve ekonomike të organizatës. Standardet për pregaditjen dhe raportimin e informacionit ndihmojnë në sigurimin e besueshmërisë së pasqyrave financiare.

Auditimi i pasqyrave financiare përcakton nëse pasqyrat e përgjithshme financiare japin pamjen e vërtetë dhe të sinqertë duke iu përmbjatur kriterëve specifike. Si kriter shërbejnë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK).

Pasqyrat financiare të cilat auditohen zakonisht janë:

- a. Bilanci i gjendjës;
- b. Pasqyra e rrjedhjes së parasë (Cash Flow);
- c. Pasqyra e të ardhura, dhe
- d. Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet.

Synimi i auditimit të pasqyrave financiare është t'i mundësohet auditorit të shprehë mendimin se këto pasqyra janë përpiluar sa i përket aspektit material në pajtim me kornizën raportuese në fuqi. Që ta përmbushë këtë auditori siguron prova të mjaftueshme dhe të caktuara si themel të përfundimit të vet.⁷⁰

Opinion i audituesit e përforcon besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe ndihmon në rritjen e besimit të veprimtarive ekonomike të ndërmarrjeve. Si objektiv kryesor i auditimit të jashtëm është t'i mundësohet auditorit që ta shprehë opinionin nëse pasqyrat financiare të publikuara japin 'një pamje të vërtetë e të sinqertë' të pozicioneve financiare dhe rezultateve të veprimtarive për periudhën për të cilën janë pregaditur pasqyrat.⁷¹

⁷⁰ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, (ISA), IFAC, 2000, faqe 11

⁷¹ Dr.L.Zager, B.Tusek, Revizija, Zagreb, 2007, faqe 65

Për të formuar një opinion mbi pasqyrat financiare, audituesi kërkon të arrijë një siguri që informacionet në përmbajtje të dokumentëve kontabël të paraqitura dhe të dhënat e tjera bazë janë të besueshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur pregaditjen e pasqyrave financiare. Raporti i auditimit, ose mendimi i auditimit, japin një njoftim publik të besimit të auditorit mbi ndershmërinë dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Puna e një auditori të jashtëm është:

- a. Të bëjë hetimin periodik me një kohë të kufizuar kohore;
- b. Të bëjë hetimin e sektorëve të ndryshëm të organizatës, e më së shpeshti të kontabilitetit duke vlerësuar kryesisht rregullsinë juridike të veprimeve afariste.

3. Përgjegjësia e auditorëve për të marrë parasysh rreziqet në pasqyrat financiare

Auditori dhe menaxhmenti i ndërmarrjes së cilës i bëhet auditimi kanë përgjegjësi të ndara dhe të veqanta. Auditori është përgjegjës për formulimin dhe dhënien e opinionit për pasqyrat financiare. Kurse në anën tjetër menaxhmenti kanë përgjegjësinë për përpilimin dhe prezantimin e pasqyrave financiare në pajtim me rregulat dhe standardet e pranuar për pregaditjen e tyre. Fakti se pasqyrat financiare janë të audituara nuk e lirojnë menaxhmentin nga përgjegjësia mbi anomalitë e mundshme në pasqyrat financiare.

Pra, auditori për shkak të natyrës së evidencave të auditimit mund të jap vetëm një siguri të arsyeshme, por jo absolute që janë gjetur anomalitë matreiale ose ndonjë gabim në pasqyrat financiare⁷². Auditori nuk ka asnjë përgjegjësi për të planifikuar dhe kryer auditimin për të përfituar një siguri të arsyeshme për sa i takon anomalive jomatreiale, qofshin këto të shkaktuara nga ndonjë gabim, mashtrim ose akt illegal.

Pasqyrat financiare të cilat përpilohen nga menaxhmenti përmbajnë pohime rreth përbërësve të pasqyrave financiare. Nga provat e mbledhura nga zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, auditorët deklarojnë që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomaly material të paraqitura në mënyrë të gabuar. Materialiteti është një kriter për caktimin e rëndësisë së keqvendosjeve të mundshme të pasqyrave financiare të audituara⁷³.

Pasqyrat financiare përmbajnë vlerësime dhe vendosje që varen nga vendimi i menaxhmentit. Përveq kësaj në gjetjen e gabimeve në rexhistrimet

⁷² Dr.L.Zager, B.Tusek, Revizija, Zagreb, 2007, faqe 129

⁷³ Robert W. Ingram, Thomas Albright and Bruce A. Buldwin, Financial Accounting, faqe 262

kontabël, auditorët mund të mos bien dakord me menaxherët për vlerësimet dhe caktimet e tyre. Përderisa këto gabime dhe mosmarrëveshje janë matreiale (të rëndësishme) për shumën e përgjithshme të paraqitur në raportet financiare, gjithsesi auditorëve nuk u kërkohet të marrin masa për këto qështje.

Menaxhmenti është përgjegjës për pregaditjen e pasqyrave financiare dhe informacionet lidhur me to që raporton në mënyrë të drejtë veprimtaritë e biznesit të një ndërmarrje. Menaxhmenti është gjithashtu përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi të auditimit të brendshëm.⁷⁴

Standardet e auditimit i klasifikojnë pohimet e menaxhmentit në pesë kategori:

1. Ekzistenca ose ndodhja,
2. Plotësia,
3. Të drejtat dhe detyrimet,
4. Vlerësimi dhe shpërndarja, dhe
5. Paraqitja dhe shpalosja.

Puna e një auditori të pavarur përmban realizimin e përfitimit dhe vlerësimit të evidencës që ka të bëjë me këto pohime. Megjithatë, është poashtu e mundur që një auditor të kryejë një auditim në përputhje me SNA dhe të japë një opinion pa rezervë, ndërkohë që pasqyrat financiare të përmbajnë akoma anomaly matreiale.

4. Ndikimi i auditimit të jashtëm në ngritjen e cilësisë së raportimit financiar

Ruajtja e një sistemi të besueshëm të kontabilitetit dhe e raportimit të informacionit, që paraqet ndershmerisht veprimtaritë ekonomike të ndërmarrjes është një detyrë e rëndësishme që i shoqëron pasqyrat financiare të një ndërmarrje. Auditorët e lëshijnë një raport auditimi sipas përfundimit të punës së tyre të kontrollit. Auditori përpiket të verifikojë që numrat dhe shpalljet e bëra nga menaxhmenti në raportet e tij financiare janë në përputhje me pozitën financiare të ndërmarrjes, rezultatet operuese dhe rrjedhjen e parave.

Auditori në raportin e auditimit, gjatë shqyrtimit të gjetjeve të bëra në pasqyrat financiare jep edhe ndikimin e këtyre gabimeve në pasqyrat financiare , poashtu edhe rekomandimet se si duhet të veprohet me tutje në mënyrë që pasqyrat financiare të pregaditen sa me drejtë dhe të paraqesin pamjen e vërtetë dhe të plotë të entitetit që auditohet. Menaxhmenti i

⁷⁴ Auditing & Assurance Services; A systematic approach Messier, W. and C. Emly, Mc Grow – Hill, Ryerson Limited, 2005, faqe 169

ndërmarrjes është përgjegjëse që t'i merr për bazë rekomandimet e bëra nga ana e auditorit të jashtëm.

Planet e Zbatimit dhe Përcjelljes së Rekomandimeve janë rrënjësore për monitorimin e implementimit të rekomandimeve të Auditimit të Jashtëm mbi përmirësimin e kontrollit dhe ngritjen e cilësisë së raportimit financiar. Plan i Zbatimit duhet të përgaditet për secilin auditim të kompletuar. Ai duhet të regjistrojë të gjitha rekomandimet dhe datën e implementimit të tyre.

Ndjekja e rekomandimeve duhet të mbështetet nga të dhënat mbi rekomandimet e bëra më parë. Ndjekja e rekomandimeve mund të bëhet nga:

- Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve;
- Përfundimi e rishikimit të dokumenteve, i cili përfshin një rishikim më të detajuar të zbatimit të rekomandimeve, por nuk përfshin vëzhgimin në terren;
- Një rishikim të detajuar që përfshin vëzhgimin në terren në lidhje me rekomandimet e bëra gjatë raportit të auditimit;
- Një rishikim të përgjithshëm të rekomandimeve kryesore që janë të njëjtit tip në të njëjtin ent ose në ente të ndryshme për të analizuar arsyet e përbashkëta të ecurisë/vazhdimësisë së ngritjes së cilësisë së raportimit financiar.

Procesi i ndjekjes së rekomandimeve është jetësor për arsye se:

- përmirëson procesin e punës,
- rrit ekonomikitetin, efikasitetin dhe efektivitetin në subjekt.
- mos realizimi i rekomandimeve do të sjellë një efektivitet të ulët.

Sa më të pakta janë rekomandimet aq më cilësore do të jenë raportet financiare:

- a) Sa më të rregullta të jenë auditimet e P.F., aq më të mëdha janë gjasat për të marrë mendim kompetentë për P.F.;
- b) Sa më të rregullta të jenë auditimet P.F., aq më të pakta do të jenë rekomandimet për korigjime;
- c) Sa më të rregullta të jenë auditimet P.F., aq më cilësore dhe më të besueshme do të jenë P.F.

4. Përfundimi

Paraqitja e drejtë dhe e plotë e aktiviteteve ekonomike të ndërmarrjeve dhe prezantimi i pasqyrave financiare është i nevojshëm për shumë shfrytëzues të brendshëm dhe të jashtëm. Kontabiliteti është kritik për veprimet e një ekonomie tregu. Që shoqëria jonë të vazhdojë të zhvillohet është shumë e rëndësishme që ata të cilët marrin vendime t'a kuptojnë informacionin kontabël të prezantuar në pasqyrat financiare dhe

mënyrën se sit a përdorin këtë informacion për të vlerësuar aktivitetet e ndërmarrjes.

Mirëpo, që ky informacion të jetë më i besueshëm ai duhet të auditohet. Auditimi është ekzaminimi i hollësishëm i pasqyrave financiare të një ndërmarrjeje. Auditimi përfshin një hetim të detajuar e sistematik të vertetimit të pohimeve të mezxhmentit të përfshira në pasqyrat financiare. Me qëllim që auditimi të ketë efekt sa më të madh ai duhet të bazohet në një kornizë konceptuale apo në standardet dhe rregullat në fuqi.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është t'i mundësohet auditorit të shprehë mendimin e vet se prezantimi dhe përpilimi i pasqyrave financiare është bërë Brenda kornizës raportuese dhe se nuk përmbajnë ndonjë anomali materiale. Mendimi i auditorit e rrit besueshmërinë e pasqyrave financiare. Auditori i verifikon pasqyrat financiare nëse ato paraqesin drejtësisht veprimtaritë e biznesit të një ndërmarrjeje. Auditori nuk përbënë ndonjë garanci që ndërmarrja do të jetë e suksesshme. Nëse një ndërmarrje nuk ecën mirë pasqyrat financiare të saj duhet t'i paraqesin problemet. Informacioni i mirë nuk nënkupton që një ndërmarrje po ecën mirë ose se investitorët mund të nxjerrin kthime të larta. Auditori verifikon cilësinë e informacionit financiar, jo cilësinë e menaxhimit ose aftësisë së menaxhmentit për të marrë vendime të drejta biznesi.

5. Referencat

1. Grup autorësh, Auditim, Tiranë, 2007.
2. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA), IFAC, 2000.
3. Dr. L. Zager, B. Tusek Revizija, Zagreb, 2007.
4. William f. Messier Jr, DBA, CPA AUDITING, Mc Graw – Hill, INC.
5. Douglas R. Carmichel, John J. Willingham, Auditing Concepts and Mc Grow Hill INC.
6. RICK Hayes, Arnold Schilder, Roger Dessen, Phil Wallaye, PRICIPLES OF Auditing and INTERNACIONAL PERSPECTIVE, Concepts and methods McGraw – Hill, INC.
7. Abbott, L. J. and S. Parker. 2000. Auditor selection and audit committee characteristics. *Auditing: A Journal of Practice & Theory* 19.
8. Abbott, L. J., S. Parker, G. F. Peters. 2001. The effectiveness of blue ribbon recommendations in mitigating financial misstatements: an empirical study. *Auditing Mid-year Conference*. Houston, Texas.

9. Carcello, J., D. R. Hermanson, T.L. Neal and R. Riley, Jr. 2002. Board characteristics and audit fees. *Contemporary Accounting Research*.
10. Carcello, J., and T.L. Neal. 2003. Audit committee characteristics and auditor dismissals following “new” going concern reports. *The Accounting Review* .
11. Cutting, Thomas (January 12, 2008). "How to Survive an Audit". PM Hut.